



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 34
Prishtinë, më 7 tetor 2016, në orën 9:40
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

P r o c e s v e r b a l

i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Z. Elmi Reçica, znj. Blerta Deliu-Kodra, znj. Luljeta Veselaj-Gutaj, z. Pal Lekaj dhe z. Zafir Berisha.

Munguan: Znj. Teuta Rugova, Z. Qerim Bajrami, Z. Ismet Beqiri dhe Znj. Puhie Demaku.

Delegacioni ishte në përbërje prej: Z. Klaus Neumann, znj. Margrid Neumann, z. Rainer Neumann, z. Jürgen Naulin, znj. Sabine Naulin, z. Christoph Decker, znj. Renate Decker, znj. Erika Schmidt-Petry, znj. Margrid Hilmer, z. Manfred Semmer, znj. Helga Semmer, z. Démetrè Zavlaris, znj. Maja Dulce, z. Karl Thöhne dhe znj. Gabriele Thöhne.

Nga zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Gurjeta Zeka - LVV, Argjend Zejnaj - AAK, Taulant Salihu - KREK.

Mbledhjen e kryesoi: Elmi Reçica, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

Takim me përfaqësues të shoqatës “Berliner Kellerrunde” nga Berlioni

Elmi Reçica, përfaqësuesve të shoqatës gjermane "Berliner Kellerrunde", u dëshiroi mirëseardhje duke theksuar se i jemi mirënjohës shtetit gjerman, sepse në të gjitha fazat e historisë ishin afër Kosovës. U jemi mirënjohës tha z. Reçica se pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë shumë shqiptarë

janë mirëpritur në Gjermani, ku kanë jetuar e punuar, i kanë ndihmuar familjet e tyre në Kosovë dhe kanë hapur shtigje të reja bashkëpunimi. Me ndihmën e Gjermanisë, ne kemi realizuar lirinë, e më vonë edhe pavarësinë e shtetit tonë, ndërsa tani përderisa jemi në fazën e shtet ndërtimit dhe integritimeve ndërkombëtare, na është e nevojshme përkrahja e mbështetja e mëtejme e Gjermanisë dhe vendeve mike, theksoi z. Reçica. Ai po ashtu njoftoi përfaqësuesit e shoqatës për përbërjen e Kuvendit të Kosovës dhe bëri të ditur se Kosova është një shtet, ku demokracia parlamentare është parësore.

Klaus Neuman, kryesues i delegacionit të Shoqatës, "BerlinerKellerrunde", fillimisht e prezantoi delegacionin e tij dhe bëri të ditur se është i njoftuar për Kosovën edhe nga ambasadori i Kosovës në Gjermanisë. Duke u ndërlidhur me numrin e madh të të rinjve në Kosovë, u interesua për perspektivën e tyre ngase shumica nga ata synojnë ta braktisin vendin, tha z.Neuman. Pyeti se çfarë mund t'ju afrojë klasa politike kosovare këtyre të rinjve.

Blerta Deliu-Kodra e njoftoi delegacionin se në Gjermani ka qëndruar për 3 vjet dhe ka përjetuar personalisht ndihmën e shtetit gjerman, pasi që ka qenë nga zona e luftës dhe ka pasur fatin të shpëtojë dhe të trajtohet nga shteti gjerman për çka ajo u falënderua. Shteti i Kosovës si një shtet i ri në tranzicion pas luftës tha se ka edhe sfidat e tija. Problemin kyç të gjeneratës së re, tha se do ta lidhte nga fakti se Kosova është një vend i vogël dhe nuk ka zhvillim ekonomik, nuk ka hapje të vendeve të punës dhe me faktin tjetër, mungesën e liberalizimit të vizave.

Zafir Berisha tha se është kënaqësi të kemi një takim të kësaj natyre dhe se, Gjermaninë e konsideron si një shtëpi që i ka ndihmuar qytetarët e Kosovës. Njoftoi se Kosova po kalon nëpër periudha të vështira të zhvillimit ekonomik. Kjo ngecje tha se nuk na takon vetëm neve që jemi bartës të jetës politike në Kosovë, sepse për vite të tëra bashkësia ndërkombëtare, misioni i UNMIK-ut, e pastaj EULEX-i kanë pasur shumë kompetenca pas luftës. Edhe për kundër bisedimeve që jemi duke i zhvilluar në Bruksel me Serbinë, ajo po bën obstrukcione ndaj zhvillimit të shtetit të Kosovës dhe integritetit të saj. Roli i Gjermanisë, por edhe i vendeve të tjera në rajon për përmirësimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë është shumë domethënës. Më tej z. Berisha theksoi se një qasje serioze e ndërkombëtarëve dhe vendësve do të mund ta bënte Kosovën një vend model në rajon. Pa marrë parasysh pozicionet tona politike për çështjen e Kosovës e gjithë klasa politike është bashkë dhe e vendosur që ta bëjë Kosovën një vend evropian, për çka na nevojitet ndihma dhe përvoja juaj.

GabrieleThöhne theksoi se për papunësinë e madhe që e ka Kosova rreth 35%, Kosovës i duhet një shtim i bruto produktit vendor prej 4 – 7%, për të mbajtur këtë gjendje ekzistuese. Kosova duhet të ketë prodhim dhe eksport. Si shtylla kryesore të shtetit të Kosovës konsideron pos çështjes së sigurisë, shkollimin dhe rendin juridik, të cilat tha se do të ndihmonin investimin e huaj.

Pal Lekaj duke u ndërlidhur me çështjen e emigrantëve tha se kjo varët nga politika, pasiguria e një vendi, zhvillimi ekonomik dhe perspektiva për të rinjtë, që nuk e shohin shumë të afërt. Theksoi se është detyrë e jona që të fokusohemi në rendin dhe ligjin, zhvillimin ekonomik, stabilitetin ekonomik, dhe të kemi një vizion të qartë se si do t'i qasemi zhvillimit ekonomik që

të rinjtë tanë të mos e lëshojnë Kosovën. Ne kemi trashëguar një sistem të ekonomisë së ndërmarrjeve të mëdha të cilat janë shkatërruar gjatë luftës dhe tani kemi filluar pothuajse nga zero. Z. Lekaj tha se nuk kemi pasur ndonjë vizion të qartë se, a të orientohemi në ndërmarrje të mëdha apo të fokusohemi në ndërmarrje të mesme apo biznese. Njëkohësisht bëri të ditur se edhe sistemin arsimor nuk e kemi në përputhje me tregun.

Elmi Reçica:Ne kemi një diasporë e cila ka arritur suksese në Gjermani dhe shpresojmë se me investimet e tyre këtu, do të jenë të suksesshëm. Po ashtu tha se edhe përmes kredive të buta pretendojmë të investojmë në zhvillim ekonomik të vendit. Sa i përket orientimeve politike te ne, shumica e partive politike janë me orientim qendër e djathtë, ka edhe parti që janë liberale dhe parti që janë qendër e majtë, por secila prej tyre, angazhohet për një shtet social, theksoi Reçica.

Luljeta Veselaj-Gutaj:Gjermaninë dhe popullin gjerman tha se e konsideron si një mik shumë të fuqishëm të Kosovës. Shkollimi profesional tha se është shumë i rëndësishëm për Kosovën, në mënyrë që të angazhohemi për orientime profesionale, por në këtë drejtim na nevojitet eksperiencia dhe mbështetja e shteteve mike. Të rinjtë e Kosovës, pas shkollimit të mesëm, të vetmin orientim e kanë kyçjen në universitet, sepse në mungesë të orientimeve profesionale ata nuk mund të kyçen në tregun e punës. Kosova ka shumë njerëz, të specializuar jashtë vendit në fushën e shëndetësisë, por atyre u mungon aparatura mjekësore për ta ushtruar profesionin e tyre. Bazuar në ligjin për sigurimet shëndetësore, pritet që nga viti 2017 të fillohet me zbatimin e sigurimeve shëndetësore për qytetarët e Kosovës. Me nënshkrimin e MSA-së znj. Gutaj tha se është hapur një epokë e re për Kosovën dhe se jemi duke punuar intensivisht që të fillojmë me eksport në vendet e tjera.

Zafir Berisha tha se ne, si opozitë dhe pozitë, i kemi identifikuar objektivat e shtetit, pa një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e dimë që Kosova do të ngecë. Ngecjen e Kosovës e sheh edhe me fajin e bashkësisë ndërkombëtare, e cila vendosi UNMIK-un, pasojat e të cilit Kosova është ende duke i vuajtur për shkak të qasjes së gabuar të tyre në privatizim, me njerëz jo profesionalë, të cilët në shumë sfera të jetës sonë, kanë vënë bazat e gabuara.

Pal Lekaj bëri të ditur se Kosova e ka bruto produktin vendor, më të ulët në rajon. Edhe nëse do ta kemi një ngritje ekonomike prej 3 –3.5%, në dy vitet e ardhshme, tregut tonë i nevojitet t'i absorbojë 25 000 punëtorë në vit, gjë që nuk do të mund t'i absorbojë. Kërkoj nga delegacioni i shoqatës që ta ndihmojë Kosovën në zhvillim ekonomik, sepse Kosova e ka një gjeneratë të re që e respekton shumë Gjermaninë dhe që i duhet përkrahja. Edhe ne duhet të obligohemi që të krijojmë rend dhe ligj, të luftojmë korrupsionin dhe të sigurojmë investitorët, se ka llogaridhënie.

Klaus Neumann falënderoi deputetët për takimin dhe dëshiroi që ky takim të hap perspektivën për të rinjtë kosovarë.

Elmi Reçica falënderoi delegacionin për vizitën dhe kërkoj që Gjermania ta mbështesë edhe në të ardhmen Kosovën, duke theksuar se do të angazhohemi për të krijuar një perspektivë që të rinjtë tanë të qëndrojnë në vend.

Z. Reçica, delegacionit të shoqatës gjermane " BerlinerKellerrunde ", në përfundim të takimit, në shenjë respekti i dhuroj dy dhurata simbolike.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

ElmiReçica